

**Sipërmarrja dhe Vetëpunësimi:  
Fondi i Mikrokredive të Biznesit**

**Thirrje<sup>1</sup> për përzgjedhjen e përfituesve**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për  
grante: **4 maj 2024**



<sup>1</sup> Thirrje në kuadër të nismës "Rezistenca marginale: modeli i ekonomisë qarkulluese për zhvillimin e profesioneve specifike të territorit" - e identifikuar me kodin AID 012314/02/5 - aprovuar dhe miratuar për financim në kuadër të Thirrjes për dhënie me koncesion të kontributeve për nismat e paraqitura nga autoritetet lokale për "Promovimin e partneriteteve territoriale dhe zbatimin territorial të Agjendës 2030" - GURI - Fletorja Zyrtare e Republikës Italiane, seria e përgjithshme e datës 27 dhjetor 2019, nr. 302

## PARATHËNIE DHE PËRMBAJTJA

Thirrja për “Vetë sipërmarrjen dhe Vetëpunësimin: Fondi i Mikrokredive të Biznesit” është pjesë e nismës "Rezistenca marginale: modeli i ekonomisë qarkulluese për zhvillimin e profesioneve specifike të territorit" (më tej referuar si “Projekti”) – e identifikuar me kodin AID 012314/02/5 – aprovuar dhe miratuar për financim në kuadër të Thirrjes për dhënie me koncesion të kontributeve për nismat e paraqitura nga autoritetet vendore për "Promovimin e partneriteteve territoriale dhe zbatimin territorial të Agjendës 2030" – GURI - Fletorja Zyrtare e Republikës Italiane, seria e përgjithshme e datës 27 dhjetor 2019, nr. 302.

Projekti kryhet në Partneritet Territorial me subjektet e mëposhtme: Rajoni i Pulias si Partner Kryesor, Qarku i Vlorës, Bashkia e Vlorës dhe Bashkia e Himarës, si Palë përfutuese; Administrata e Provincës së Leçes, Bashkia e Casavecchios në Rajonin e Pulias, Grupi i Nismave Lokale (GAL) Meridaunia dhe Biznes Albania, si partnerë; Shoqata Kombëtare e Komunave Italiane (ANCI) Puglia, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës së Republikës së Shqipërisë, si Partnerë të Asociuar.

Projekti ka një kohëzgjatje totale prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh, duke filluar nga data 15 shkurt 2022, me një vlerë të përgjithshme financiare prej 1,468, 033.77 eurosh.

Objektivi i përgjithshëm i Iniciativës është të orientojë proceset e zhvillimit të territorit drejt objektivave të Axhendës 2030 dhe të përmirësojë kapacitetin qeverisës të Autoriteteve Vendore të piketuara për planifikimin dhe zbatimin e politikave *place - based* apo e thënë ndryshe, politikave që bazohen mbi karakteristikat e territorit ku kryhen aktivitetet e projektit. Në veçanti, projekti ka këto qëllime:

- të përmirësojë kapacitetin planifikues, parë kjo nga perspektiva e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese;
- të përmirësojë nivelin e shërbimeve të ofruara për qytetarët nga administratat publike të piketuara, duke rritur potencialin socio-ekonomik lokal dhe prirjet specifike territoriale, në zbatim të parimeve të ekonomisë qarkulluese.

Këto objektiva do të mund të arrihen nëpërmjet kryerjes së një planifikimi në një zone të gjerë, i cili, në përpjekje për të promovuar veçantinë dhe karakteristikat lokale, do të kontribuojë gjithashtu edhe në reduktimin e hendekut territorial midis pjesës së brendshme tokës dhe bregdetit. Projekti përfshin zbatimin e një sërë aktivitetesh, siç janë:

- Përcaktimin e një Plani Strategjik për Prirjet Territoriale, ose më saktë, një strategji për vlerësimin e karakteristikave lokale;
- Krijimin e një mikro qendre për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, pasi të jetë kryer një kursi trajnimi i përshtatshëm dhe të jenë ndjekur veprimet e duhura të marketingut;
- Krijimin e një mikro **qendre të përpunimit të produkteve të qumështit**, ku përfshihen **aktivitete të kualifikimit të produkteve dhe nisja e start-up-ëve të rinjve**, të aktivizuara **nëpërmjet dhënies së mikro-kredisë**;
- Aktivitete inovative të komunikimit, për t'i dhënë vizibilitet projektit dhe për të përforcuar rrjetin institucional të punës.

Me qëllim që të zbatohen kushtet lehtësuese të përmendura në këtë Thirrje, Provinca e Leçes dhe Biznes Albania, si partnere të Iniciativës, dhe Bashkia Himarë, si Kundër palë, kanë për qëllim të mbështesin nismat sipërmarrëse në funksion të **qendrës së përpunimit të prodhimit të qumështit** nëpërmjet instrumentit të mikrokredisë.

## 1. OBJEKTI DHE QËLLIMI I THIRRJES

**Kjo thirrje ka si qëllim të përzgjedhë përfituesit e kushteve lehtësuese të kredisë për nismën "Vetë sipërmarrja dhe Vetëpunësimi: Fondi i Mikrokreditit të Biznesit".**

Fondi i Mikrokredive ofron dhënien e kredisë me anë të ndërhyrjeve lehtësuese, duke mbështetur lindjen e bizneseve të reja apo forcimin e mikro bizneseve ekzistuese, si nëpërmjet stimujve të drejtpërdrejtë ashtu edhe nëpërmjet ofrimit të shërbimeve; mikrokredia ofron mbështetje financiare konkrete, veçanërisht për ata që nuk plotësojnë kushtet apo nuk kanë kapitalin pasuror për të hyrë në tregun tradicional të kredisë.

Instrumenti i mikrokredisë mundëson përmirësimin e procedurave për marrjen e kredisë, duke lehtësuar në këtë mënyrë personat në disavantazh, ata që gjenden në situata të vështira sociale ose personat me nivel të ulët arsimor.

Mikrokredia ka për qëllim edhe krijimin e bizneseve rinore, si dhe forcimin e aftësive të orientuara drejt prodhimit dhe shitjes së produkteve të qumështit.

Në zonën e Himarës, shumë familje jetojnë me të ardhurat e bizneseve të tyre të vogla bujqësore ose thjesht falë punës së individëve, e cila zhvillohet në një kontekst të ekonomisë informale; vështirësia për të marrë kredi bankare për shkak të pamjaftueshmërisë ose mungesës së garancive reale dhe për shkak të përmasave jo të mëdha të sipërmarrjeve, të cilat konsiderohen si shumë të vogla nga bankat tradicionale, nuk i jep mundësinë këtyre aktiviteteve prodhuese të nisin dhe të zhvillohen lirshëm sipas rregullave të tregut. Në veçanti, i referohemi atyre aktiviteteve në sektorin e bujqësisë dhe të blegtorisë që shpesh neglizhohen nga ligjet kombëtare që përmbajnë lehtësira për këto biznese, por që me kalimin e kohës, kanë marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe dhe shpesh përfaqësojnë elementin diskriminues për suksesin e një territori, duke pasur parasysh madje edhe inovacionin e fuqishëm të procesit dhe të produktit, në të cilin këta sektorë janë të interesuar për kalimin nga sistemi tradicional në atë të mekanizuar dhe atë të prodhimit industrial.

Shërbimet e kualifikimit për prodhimin ekzistues të produkteve të qumështit do të aktivizohen nëpërmjet përmirësimit të standardeve të prodhimit, me ndihmën e pajisjeve që kujdesen për aspektet higjieno-sanitare dhe cilësore të produkteve.

Do të vihen në punë aksione që lehtësojnë futjen e produkteve në tregun vendas dhe atë kombëtar, si dhe aksione për njohjen e certifikimit, në bazë të protokolleve të prodhimit dhe përfshirjen e organizmave certifikues në Shqipëri për rritjen e vlerës së produkteve tipike lokale të qumështit. Kjo lloj mbështetjeje do t'u jepet sidomos fermerëve dhe blegtorëve që operojnë tashmë në zonë.

## 2. KARAKTERISTIKAT E VEPRIMEVE LEHTËSUERE

Veprimet lehtësuese kanë për qëllim të mbështesin programe të investimeve të plota dhe organike, të lidhura funksionalisht me aktivitetet e Qendrës së transformimit të produkteve të qumështit, me vendndodhje në Vranisht, një zonë të brendshme rurale e rezervuar për rritjen e deleve, ku është kryer një ndërhyrje rrënjësore e ristrukturimit, modernizimit, rinovimit si edhe të përshtatjes higjieno-sanitare të një pasurie të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Himarë, e përdorur më parë si infrastrukturë ushtarake. Qendra e përpunimit ka pajisjet bazë të nevojshme, në mënyrë që prodhuesit vendas të ofrojnë qumështin e tyre dhe nënproduktet e tij në tregun vendas.

Për të menaxhuar të gjitha fazat administrative në lidhje me veprimet lehtësuese, është krijuar një Grup Vlerësimi i përbërë nga:

- një anëtar i provincës së Leçes, si President;

- një anëtar i Bashkisë Himarë;
- një anëtar i Biznes Albania

Subgrantimi ka një vlerë totale prej 45,000.00€ (dyzet e pesë mijë euro/00).

Ky veprim lehtësues synon financimin e shpenzimeve që lidhen me realizimin e llojeve të mëposhtme të investimeve:

- deri në 5000.00 euro për blerjen e bagëtieve në numër krerësh (si dele dhe/ose dhi dhe/ose gjedhë);
- nga 5,001,00 euro deri në maksimum 15,000,00 euro për blerjen e shërbimeve të konsulencës dhe/ose të pajisjeve.

Investimet duhet të kontribuojnë në aksione:

- A) *për subjektet që i përkasin kategorisë A, referuar nenit nr. 3 të kësaj Thirrjeje: forcimit të biznesit, nëpërmjet investimeve të vogla materiale dhe/ose jo materiale*
- B) *për subjektet që i përkasin kategorisë B), nr. 3 të kësaj Thirrjeje: aktivizimi i një nisme sipërmarrëse në formën e një sipërmarrjeje individuale ose mikro-ndërmarrjeje*

Përfituesit e Fondit të mikrokredisë do të kenë gjithashtu mundësi aksesit në rrugëtimin që shoqëron krijimin e biznesit.

## 2.1 Shpenzimet e pranueshme

### Blerja e bagëtieve

Janë të pranueshme shpenzimet që lidhen me blerjen e bagëtieve (dele, dhi, gjedhë) të përshtatshme për sigurimin e qumështit ose të nënprodukteve të tij për Qendrën e përpunimit dhe të prodhimit të qumështit në pronësi të Bashkisë Himarë, me vendndodhje në Vranisht.

### Blerja e shërbimeve të konsulencës

Shpenzimet që lidhen me blerjen e shërbimeve të konsulencës teknike në lidhje me investimin, të ofruara nga organe publike ose private të organizuara nga ana teknike dhe që kanë të bëjnë me:

- konsulencë IT në përgjithësi;
- konsulencë për përmirësimin e cilësisë së produktit;
- konsulencë për përmirësimin e organizimit të kompanisë.

### Blerja e pajisjeve

Janë të pranueshme shpenzimet që kryhen për blerjen e pajisjeve (makineri, sisteme, automjete komerciale, orëdi, pajisje ndriçimi, sisteme etj.) të cilat paraqesin një shkallë të lartë inovacioni në krahasim me ciklin aktual të prodhimit dhe janë të përshtatshme për përmirësimin e fazave të punës. Pajisjet e mbuluara nga subvencionimi mund të jenë ose të reja nga fabrika, ose të përdorura, në gjendje të mirë pune dhe duhet të jenë të lidhura funksionalisht, për sa i përket përdorimit të tyre, ato duhet të lidhen me aktivitetin ekonomik të kryer nga përfituesi dhe të përfshihen në strukturën logjistike të njësisë së prodhimit.

Gjithashtu, janë të pranueshme edhe shpenzimet në lidhje me blerjen e harduerit, softuerit bazë dhe të aplikacioneve, edhe nëse janë të personalizuar për kompaninë dhe janë funksionale për nevojat e projektit.

Shpenzimet e faturuara ose të kryera përpara datës së publikimit të kësaj Thirrjeje nuk janë të pranueshme.

Kostot që lidhen me blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve të makinave të faturuara nga përfituesi nuk mund të jenë objekt i subvencionit.

Shpenzimet e subvencionuara nuk mund të jenë objekt i ndihmës së mëtejshme, të dhënë në çfarëdo forme tjetër nga legjislacioni tjetër kombëtar, rajonal dhe/ose komunitar.

Tek faturat që lidhen me shpenzimet e mbuluara nga kontributi, përfituesi duhet të vendosë, me gjobë për reduktimin e përfitimit përkatës, edhe nëpërmjet përdorimit të një vule të caktuar, fjalët: "blerje e kryer me Fondin e Mikrokreditit të Biznesit".

Blerjet duhet të kryehen në mungesë totale të situatave të konfliktit të interesit, sipas legjislacionit aktual.

## **2.2 Kufijtë për dhënien e kontributeve**

Vlera e kushteve lehtësuese apo e përftimeve është e barabartë me 100% të investimit të pranueshëm për kontribut (me TVSH) duke u konsideruar si të përshtatshëm dhe të rëndësishëm për këtë investim dhe të pranuar si veprim.

Përfitimi do të jepet në formën e një kontributi të pakthyeshëm.

## **2.3 Dhënia i kontributit**

Kontributi do të paguhet në dy këste:

- 70% e shumës do të paguhet paraprakisht, brenda 15 ditëve nga paraqitja e faturave të pa arkëtuara nga ana e përfituesit;
- 30% pjesa e mbetur, brenda 15 ditëve nga paraqitja e faturave të arkëtuara nga përfituesi.

## **2.4 Koha dhe metodat e kryerjes së investimit**

Investimi duhet të realizohet tërësisht brenda 120 ditëve nga data e komunikimit të pranimit për subvencionim. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë, për një periudhë kohore prej jo më shumë se 30 ditësh, me kërkesë të përfituesit, e cila i dërgohet Grupit të Vlerësimit të paktën 30 ditë përpara afatit të lartpërmendur.

Investimi konsiderohet i realizuar plotësisht kur:

1. Janë paguar plotësisht të gjitha shpenzimet në lidhje me investimin;
2. Raportimi i shpenzimeve është bërë përmes paraqitjes së të gjitha dokumenteve të shpenzimeve dhe pagesave të kryera;
3. Është marrë vërtetimi ose certifikata përkatëse, në rast se parashikohet lëshimi i certifikatave apo i vërtetimeve.

Lejohen ndryshime të mundshme në propozimin e investimit vetëm për nevoja të vërtetuara, me paraqitjen paraprake të preventivëve të rinj për investime me karakteristika teknike të ngjashme me ato që do të zëvendësohen. Ndryshimet duhet të miratohen nga Grupi i Vlerësimit.

## **2.5 Kontrollat dhe inspektimet**

Biznes Albania gëzon të drejtën të kryejë kontrolle teknike, administrative dhe financiare në selinë e regjistruar dhe/ose operacionale të përfituesit, për të vërtetuar korrespondencën reale ndërmjet propozimit të investimit të pranuar në kontribut dhe investimit të bërë, në çdo fazë të zbatimit të investimit.

Për qëllime të kontrolleve dhe të inspektimeve, si dhe të faturave të mbajtura në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual, mund të kryhen kontrolle për çdo gjë tjetër të nevojshme, në mënyrë që të verifikohet vlefshmëria dhe rregullsia e procedurave në përputhje me legjislacionin aktual.

## 2.6 Revokime dhe sanksione

Kushtet lehtësuese revokohen në rastet e mëposhtme:

- a) nëse investimi nuk është realizuar;
- b) nëse kërkesa për pagesë përfundimtare dhe dokumentacioni përkatës nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3;
- c) mospërfundimi i investimit brenda afateve të përcaktuara, duke përfshirë çdo zgjatje të mundshme;
- d) nëse pas kontrolleve dhe inspektimeve konstatohet mungesa e kushteve të nevojshme për marrjen e përfitimeve;
- e) paraqitja ose deklarimi i të dhënave të pavërteta;
- f) disbursimi i financimit, të marrë nga subvencione të tjera publike për të njëjtën ndërhyrje.

Në rast rikuperimi të shumave të paguara, në vijim të dispozitave të revokimit të përmendura në këtë nen ose pas mospagimeve nga përfituesi, shumat e financuara do të rikuperohen duke aplikuar interesat e ligjshme.

Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë Thirrje do t'i referohemi legjislacionit aktual, në rast mosmarrëveshjeje, gjykata kompetente do të jetë ajo e Vlorës.

## 3. KUSHTET PËR PRANINIMIN E PËRFITUESVE

Aplikimi për kontribut mund të paraqitet ekskluzivisht nga individë që i përkasin një prej kategorive të mëposhtme:

- A) mikro bizneset dhe bizneset e vogla, bizneset individuale, fermerët dhe mbarështuesit e pajisur me NIPT;
- B) të rinjtë e papunë ose të papunët që synojnë të krijojnë një person të ri juridik dhe që plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- janë banorë dhe/ose me vendbanim në territorin e Qarkut të Vlorës;
- i përkasin moshës nga 18 deri në 35 vjeç.

## 4. AFATI DHE MËNYRA E DËRGIMIT TË KËRKESËS PËR GRANT

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit për grant është data 4 Maj 2024.**

Aplikimi për kontribut duhet të hartohet sipas modelit të bashkëlidhur të kësaj Thirrjeje (**Formulari A**), i plotësuar në tërësi dhe i nënshkruar siç duhet nga:

- Përfaqësuesi Ligjor, në rastin e një personi që i përket kategorisë A, përmendur në Nenin nr. 3;
- Propozuesi, në rastin e një subjekti që i përket kategorisë B, referuar në Nenin nr. 3

Kërkesës për grant duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- a) preventivet origjinale /kontratat origjinale të shpenzimeve, që konsiderohen të pranueshme në përputhje me nenin. 2 të kësaj Thirrjeje;
- b) kopje e një dokumenti të vlefshëm identiteti të:
  - Përfaqësuesit Ligjor, në rastin e një personi që i përket kategorisë A të përmendur në Nenin nr. 3;
  - Propozuesit, në rastin e një subjekti që i përket kategorisë B të referuar në Nenin nr. 3.

Gjithashtu, subjektet që i përkasin vetëm kategorisë A, duke iu referuar nenit nr. 3 të kësaj Thirrjeje duhet t'i bashkëngjisin aplikimit për grant dokumentet e mëposhtme:

- c) Ekstraktin nga Qendra Kombëtare e Biznesit, të përditësuar jo më përpara se 3 muaj nga publikimi i thirrjes;
- d) profilin e shkurtër të kompanisë.

dhe dokumentet e bashkëngjitura të sipërpërmendura duhet të jenë në **formatin .pdf**

Aplikimi për grant dhe dokumentet e bashkëlidhura duhet të jenë në **formatin .pdf**

Aplikimi për grant dhe dokumentet bashkëshoqëruese të sipërpërmendura duhet të dërgohen **ekskluzivisht me postë elektronike** në adresën: [contact@biznesalbania.org.al](mailto:contact@biznesalbania.org.al), duke përcaktuar lëndën: Vetë sipërmarrja dhe Vetëpunësimi: Fondi i Mikrokredive për Biznes - APLIKIM.

## 5. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË PJESËMARRËSVE

Me qëllim të vlerësimit të aplikimeve për kontribute dhe, rrjedhimisht të përzgjedhjes së përfituesve të kushteve lehtësuese për kredi, Grupi i Vlerësimit do të marrë përsipër pranueshmërinë e aplikimeve duke verifikuar, sipas nenit nr. 4 të kësaj Thirrjeje:

- Metodën dhe afatet për marrjen e aplikimit për grant,
- Dokumentacionin e dërguar në mënyrë të plotë.

Më pas, Grupi i Vlerësimit do të sigurohet që subjektet pjesëmarrëse kanë plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, në përputhje me nenin nr. 3 të kësaj Thirrjeje

Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit do të vlerësojë programet e investimit të paraqitura, duke u caktuar atyre një numër pikësh, bazuar në nivelin e koherencës së programit të investimit të paraqitur me aktivitetet e Qendrës së Përpunimit e të Prodhimit të Qumështit, në pronësi të Bashkisë së Himarës, me vendndodhje në Vranisht; pikët do të caktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

KOHERENCA	NUMRI I PIKËVE
E ulët	10
Mesatare	20
E lartë	30

Të gjithë subjektet pjesëmarrëse do të njoftohen me postë elektronike për pranimin ose mospranimin e kontributit **deri më 13 Maj 2024**.

Subjektet e përfshira në renditje pikësh do të kenë të drejtë të përfitojnë nga subvencionin deri në shterimin e burimeve financiare në dispozicion.

Nëse kërkesa në lidhje me aplikimin e fundit të pranueshëm për kontribut, mbulohet vetëm pjesërisht nga disponueshmëria e mbetur, kontributi i dhënë do të jetë i barabartë me shumën e disponueshme.

Nëse pozicioni i fundit i pranueshëm në renditje është i zënë nga dy ose më shumë projekte, disponueshmëria e mbetur do të ndahet ndërmjet këtyre të fundit në përpjesëtim me koncesionet që mund të jepen.

Nëse përcaktohet disponueshmëria e re financiare si rezultat i heqjeve, revokimeve, reduktimeve të përfitimeve të dhëna, aplikimet e mëtejshme do të lehtësohen, sipas renditjes së vendosur, aty ku lejohet nga angazhimet e paracaktuara dhe koha e raportimit financiar.

## 6. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE (Ish neni nr. 13 GDPR- General Data Protection Regulation 2016/679)

Ju informojmë se, të dhënat personale të ofruara për qëllimin e kësaj Thirrjeje do të përpunohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887 për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat mbrojnë personat fizikë dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale, si edhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave.

Të dhënat personale mblidhen dhe përpunohen në baze të parimeve të korrektësisë, ligjshmërisë dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, duke përdorur, gjithashtu, metoda informatike për qëllime ekskluzive të përpunimit të të dhënave personale, të deklaruara në formularin për aplikimin të Thirrjes. Përpunimi ka si qëllim ushtrimin e funksioneve institucionale të përcaktuara në këtë Thirrje.

Të dhënat e marra pas aplikimit për pjesëmarrje do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet që lidhen me procedurën e përzgjedhjes të përmendur në këtë Thirrje.

Marrja e të dhënave dhe përpunimi i tyre është i detyrueshëm në lidhje me qëllimet e përshkruara më sipër; si rrjedhojë, çdo refuzim i mundshëm përcakton edhe pamundësinë e Kontrolluesit të të Dhënave për të ofruar shërbimin e kërkuar.

Kontakti i Përgjegjës të Mbrojtjes së të Dhënave është: [contact@biznesalbania.org.al](mailto:contact@biznesalbania.org.al)

Kontrolluesi i të dhënave personale është Biznes Albania

Të dhënat e ofruara do të përpunohen ekskluzivisht nga subjekte të emëruar posaçërisht dhe Përgjegjës të jashtëm të identifikuar nga Kontrolluesi i të Dhënave, ose nga subjekte të emëruar apo të identifikuar nga Përgjegjësi i jashtëm, të autorizuar dhe të trajnuar për këtë arsye, duke miratuar të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative, për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat legjitime, të cilat u njihen me ligj palëve të interesuara.

Të dhënat personale ruhen për një periudhë të caktuar kohore në Planin e ruajtjes dhe të mirëmbajtjes së dosjeve të Biznes Albania.

Të dhënat personale nuk do të mund të transferohen, në asnjë mënyrë, në një vend të tretë evropian, as nuk do t'u komunikohen palëve të treta, jashtë rasteve të parashikuara nga legjislacioni aktual, as në proceset e automatizuara të vendimmarrjes duke përfshirë profilizimin.

## 7. REFERENCAT

Subjekti i kontaktit për këtë Thirrje është:

Biznes Albania

Për informacione të mëtejshme mund t'i drejtoheni kësaj adrese elektronike:

E-mail: [contact@biznesalbania.org.al](mailto:contact@biznesalbania.org.al)

Teksti i kësaj Thirrjeje, së bashku me formularët përkatës, është i disponueshëm në faqen e internetit:

<https://www.biznesalbania.org.al>